



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

**MIRATOI
KRYETAR
Emiriana Sako**

PROCESVERBAL

PËR PËRGATITJEN E DOKUMENTACIONIT SIPAS URDHËRIT NR.09 DATË 14.01.2026, NR.584 PROT DATË 14.01.2026 “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E BANKËS SË NIVELIT TË DYTË QË DO TË MUNDËSOJË INSTALIMIN E PIKAVE TË SHITJES (POS) PA PAGESË DHE OFRIMIN E SHËRBIMIT TË PAGESAVE ME KARTA BANKARE NËPËRMJET KËTYRE PIKAVE NË SHESHET E PARKIMEVE PUBLIKE ME PAGESË, NË TERRITORIN E BASHKISË Durrës, SI DHE PËRZGJEDHJEN E BANKËS PËRKATËSE”

I mbajtur sot më datë ____/____/2026 në zbatim të Urdhërit “Për ngritjen e komisionit për hartimin e kriterëve të vlerësimit për përzgjedhjen e bankës së nivelit të dytë që do të mundësojë instalimin e pikave të shitjes (POS) pa pagesë dhe ofrimin e shërbimit të pagesave me karta bankare nëpërmjet këtyre pikave në sheshet e parkimeve publike me pagesë, në territorin e Bashkisë Durrës, si dhe përzgjedhjen e bankës përkatëse” nr.09 datë 14.01.2026, nr.584 prot datë 14.01.2026, hartojmë relacionin mbi kriteret në bazë të të cilave do të bëhet kualifikimi i bankave të nivelit të dytë si dhe kriteret e përcaktimit të ofertës fituese si më poshtë vijon:

RELACION

Nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës me Nr. 66, datë 25.06.2024 “Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e Bashkisë Durrës”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.61 datë 10.09.2025 ‘Për miratimin e një shtese në pikën 2 të VKB-së nr. 66 datë 25.06.2024 ‘Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e Bashkisë Durrës”, janë përcaktuar sheshet e destinuara për parkim me pagesë në territorin e zonës urbane të Bashkisë Durrës, të cilat janë: **(a)** Sheshi pranë Bar Portofino, **(b)** Sheshet në rrugën “Mars 91” Durrës (dy sheshe), **(c)** Sheshi ndodhur poshtë Urës së Dajlanit, **(d)** Sheshi “Jorgji Ziu” tek Mauzoleumi i Dëshmorëve, **(dh)** Sheshi në territorin e brendshëm të Pallatit të Sportit “Ramazan Njala”, **(e)** Sheshi pranë tregut industrial, në rrugën “Hysen Myshketa”, **(f)** Sheshi Vollga pranë Autoritetit Portual Durrës, **(g)** Sheshi 26 Nentori 1912, pranë Stacionit të Trenit, Durrës.

Aktualisht, Bashkia Durrës ka përfunduar realizimin e investimeve për vendosjen në funksion të sheshit të parkimit “Jorgji Ziu” tek Mauzoleumi i Dëshmorëve, sheshit në territorin e brendshëm të Pallatit të Sportit “Ramazan Njala” dhe sheshit Vollga pranë Autoritetit Portual Durrës.

Nëpërmjet këtyre investimeve është mundësuar vendosja e sistemeve të menaxhimit të parkimit, të cilat garantojnë efektivitet të lartë në administrimin e shërbimit të parkimit si dhe transparencë në mbledhjen e të ardhurave nga ky shërbim publik.

Tarifat e parkimit në sheshe janë përcaktuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 74, datë 23.12.2025 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2026”. Konkretisht, në pikën A.2.5.4, tabela 22 (3), janë përcaktuar tarifat si vijon:

Tarifa sipas intervalit të qëndrimit	Tarifa/Lekë
0-5 minuta falas	
0-2 orë	100
2-5 orë	200
5-8 orë	300
8-12 orë	400
12-24 orë	500
TARIFA PËR VENDPARKIM TË REZERVUAR NË SHESHE	
Paketa/Abonimi	Tarifa/Lekë
Paketë 1 mujore	10.000
Paketë 3 mujore	20.000
Paketë 6 mujore	35.000
Paketë 12 mujore	60.000

Referuar faktit që vizitorët që vijnë nga vendet e huaja, por jo vetëm, përdorin gjerësisht kanalet bankare të pagesave, konkretisht kartat bankare Visa dhe Mastercard, vlerësojmë se sistemet e menaxhimit të parkimeve duhet të përshtaten me formën e pagesave pa para në dorë (cashless), duke vendosur/instaluar në të gjitha makineritë automatike të pagesave që gjenden në sheshparkime terminalet e pikave të shitjes (Pos), të lidhur me një nga bankat tregtare, të licensuara nga Banka e Shqipërisë.

QËLLIMI I PROCEDURËS

Qëllimi i kësaj procedure është përzgjedhja e një banke të nivelit të dytë, e cila do të mundësojë:

- instalimin pa pagesë të pikave të shitjes (POS);
- ofrimin e shërbimit të pagesave me karta bankare;
- përdorimin e këtyre shërbimeve në sheshet e parkimeve publike me pagesë në territorin e Bashkisë Durrës.

Në sheshet e parkimit Jorgji Ziu” tek Mauzoleumi i Dëshmorëve, sheshin në territorin e brendshëm të Pallatit të Sportit “Ramazan Njala” dhe sheshin Vollga pranë Autoritetit Portual Durrës janë instaluar sisteme parkimi të markës CAME Parkare.

Komponentët kryesor të sistemeve të parkimit CAME Parkare janë: (a) terminali i holle hyrje/dalje, (b) terminali hyrje/dalje, (c) vendpagimi automatik, (d) terminal normal hyrje/dalje, (dh) vendpagim automatik jo me para ne dorë.

Makineria automatike e pagesës është markës CAME Parkare. Makineria është model bazë dhe funksionon pa mbikqyrje nga një operator. Të dhënat teknike të makinerisë, të nxjerra nga skeda teknike e prodhuesit të saj janë si vijon:

- Ekran minimalisht 7" TFT me ngjyra.
- Funksionimi minimalisht në 2 gjuhë (të përcaktuara nga institucioni).
- Butoni i kërkesës për ndihmë: Intercom IP bazuar në protokollin SIP, për komunikim me centralin.
- Butoni i kërkesës për biletë.
- PC i integruar, minimalisht i bazuar në arkitekturën x86 dhe mbështetje SSD për ruajtjen e të dhënave.
- Lexuesi i barkodit 1D / 2D (QR), i aftë për të lexuar kodet në bileta, letër (DIN A4, DIN A5, etj.) dhe pajisje celulare (smartphone, tablet, etj.).
- Printer termik për lëshimin e biletave elektronike në format barkodi 1D / 2D (QR), me prezantues, mbajtës dhe letër minimalisht 105 µm.
- Printeri i dytë termik 1D / 2D (QR) që do të ndërrohet me të parin kur mbaron sasia e biletave tek ky i fundit.
- Derë e përparme me kycje sigurie, me 3 pika kycje minimalisht 2mm e trashe me mbyllje me shul, të pakten në një pikë mbylljeje
- Dera anësore me çelës minimalisht prej çeliku të nikeluar, të paktën me një pikë kycjeje
- Sensorët e detyrës të hapura / të mbyllura në të dy dyert.
- Sistemi i ndriçimit të jashtëm (para) dhe të brendshëm.-
- Lidhja Ethernet me secilin komponent (TCP / IP).

Terminali i pikave të shitjes (POS) duhet të jetë një terminal i projektuar për të funksionuar pa prezencën/asistencën e punonjësve dhe duhet të integrohet plotësisht me sistemin e parkimit të markës CAME Parkare. Terminali duhet të përmbushë karakteristikat/funksionet si vijon:

- Terminali POS duhet të pranojë transaksione me kartë "VISA" dhe "MasterCard";
- Terminali POS duhet të pranojë vetëm transaksione "Contactless";
- Terminali POS duhet të kryejë vetëm transaksion "Shitje";
- Terminali POS duhet të kryejë transaksione në monedhën "Lekë";
- Terminali POS duhet të lidhet me llogarinë të dedikuar në monedhën "Lekë";
- Terminali POS duhet të kryejë mbylljen ditore automatike si edhe postim automatik të fondeve në llogarinë e Bashkisë.
- Shërbimi i pagesave me kartë bankare, nëpërmjet pikave të shitjes (POS) që do të ofrohet nga subjekti bankar, duhet të përmbushë minimalisht kushtet e mëposhtme:
- Autorizimi dhe aprovimi i transaksionit duhet të kryhet në kohë reale nga Banka sipas procedurave ndërkombëtare të skemave të pagesave (VISA & MasterCard) duke verifikuar statusin e kartës, balancën e kartës, etj;
- Çdo transaksion i suksesshëm duhet të kreditohet në llogarinë përkatëse të lidhur me Terminalin POS, jo më vonë se 2 ditë pune nga kryerja e transaksionit;

- Bashkia duhet të ketë mundësi të verifikojë transaksionet e suksesshme dhe komisionet përkatëse në çdo kohë në llogaritë përkatëse;
- Banka duhet të kryejë kthimin/anulimin e vlerës së transaksionit sipas kërkesës së Bashkisë.
- Banka duhet të mbështesë Bashkinë me raporte të ndryshme për verifikimin e aktivitetit në mënyrë të detajuar.

I. Dokumentacioni që duhet të paraqesin subjektet bankare në kuadër të shprehjes së interesit.

Subjektet bankare që do të shprehin interes për ofrimin e shërbimit të pagesave me karta bankare, në sheshet e parkimit publik me pagesë, duhet të paraqesin dokumentacionin si vijon:

- Kërkesë për shprehje interesi, ku të paqyrohen në mënyrë të përmbledhur të dhënat e subjektit bankar (cv e shkurtër e subjektit, adresat e kontaktit, personi i kontaktit) dhe eksperiencia të ngjashme të kryera në sektorin privat apo publik.
- Propozimi financiar i cili duhet të përmbajë kostot e komisioneve, të ndara sipas fashave të pagesave të përcaktuara në këtë njoftim.
- Propozimi teknik i cili do të plotësohet nëpërmjet paraqitjes së skedës teknike të terminalit të pikës së shitjes (POS), i propozuar nga subjekti bankar. Skeda përveç specifikimeve teknike duhet të përmbajë markën dhe modelin e terminalit.
- Deklaratë për vendosjen në funksion të shërbimit në përputhje me parametrat e kërkuar dhe me afatin kohor të përcaktuar në thirrjen e publikuar.
- Deklaratë për marrjen përsipër të kostove të nevojshme për integrimin/lidhjen e terminaleve POS me sistemin e menaxhimit të parkimit që ka në pronësi autoriteti publik.

I gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet në gjuhën shqipe. Dokumentat në gjuhë të huaj, duhe të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqip nga një përkthyes i licensuar.

Dokumentacioni do të paraqitet në zarf të mbyllur mbi të cilin do të jetë specifikuar emri i bankës, me emërtimin “Shprehje interesi”. Zarfi do të dëgohet pranë Bashkisë Durrës nëpërmjet shërbimit postar ose dorazi pranë zyrës së informacionit. Zarfat do të hapen ditën që përkon pas datës së fundit të paraqitjes së shprehjeve të interesit, në prezencë të përfaqësuesve të subjekteve që kanë paraqitur shprehjet e interesit.

II. Vlerësimi i shprehjeve të interesit

Vlerësimi i përgjithshëm i shprehjeve të interesit do të kryhet duke u bazuar në 3 (tre) shtylla kyesore, respektivisht: **(a)** Vlerësimi i dokumentacionit që duhet të paraqesin subjektet që shprehin interes, **(b)** Vlerësimi i propozimit teknik (*terminali POS*) në raport me kërkesat e përcaktuara në thirrjen e hapur, **(c)** Vlerësimi i propozimit financiar, (vlera më e ulët e komisioneve për secilën fashë transaksioni).

- Vlerësimi i dokumentacionit të subjekteve që kanë shprehur interes do të bazohet vetëm mbi kriterin e paraqitjes së tij në mënyrë të plotë sikurse është kërkuar.

- Vlerësimi i zgjidhjes teknike, do të bazohet në përshtatshmërinë dhe specifikimet teknike terminalit POS të ofruar nga subjekti bankar në raport me kërkesat e përcaktuara në thirrjen e hapur.

Mosplotësimi i dokumentacionit ose mospërshtatja e zgjidhjes teknike me kërkesat e përcaktuara, do të shërbejë si arsye për refuzimin e shprehjes së interesit.

- Sa i takon vlerësimin të propozimit financiar, ky vlerësim do të bazohet në një sistem pikëzimi. Për çdo fashë transaksioni do të kryhet një vlerësim me pikë, bazuar në sistemin e pikëzimit të parqitur në tabelën e mëposhtme.

Komisioni për çdo transaksion i shprehur në përqindje mbi transaksionin	
Komisioni në %	Pikë
0-1	9-10
>1-2	8-9
> 2-3	7-8
> 3-4	6-7
> 4-5	5-6
> 5-6	4-5
> 6-7	3-4
> 7-8	2-3
> 8-9	1-2
> 9-10	0-1
>10	0

III. Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit

Subjekti bankar i përzgjedhur do të ofrojë shërbimin e pagesave me karta bankare për një periudhë 3 (tre) vjeçare dhe mirëmbajtja e sistemit POS për një periudhë 3 vjeçare . Ky afat do të fillojë në momentin e nënshkrimit të kontratës/marrëveshjes ndërmjet palëve.

Ky procesverbal mbahet në shtatë kopje.